

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIONE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK/DMP	Nr. Prot. 03-2937/13
Dep. 03	Data 23.09.2013
Nr. ifaq.	Orari
Broj stranica	Date
Nr. pages	PRISHTINE

Regj. Nr.7792 /12 viti.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE –DEGA NE VUSHTRRI-
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM – DIVIZIONI I KUNDERVAJTJES,**
gjqytari duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder te pandehurit Sabri Ferati nga fsh.Sfaraqaku i Ulte Komuna e Vushtrris per kundervajtje nga neni 17 par. 1.3 te Ligjit per deklarimin , prejardhjen dhe kontrollimin e psurise te zyrtare te lart publik ike e ne pajtim me nenin 73, 195 199 me dt.17.09 /13 viti.

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Sabri / Qazim / Ferati i lindur me dt. 21.04.1963 ne fsh.Sfaraqak i Ulte Komuna e Vushtrris ku dhe tani jeton i martuar, babai i tre femijve me shtetesi Kosovar te kryer shkollen e mesme, me shtetesi Kosovar, me gjendje te meseme ekonomike deri me tani jo i denuar per kundervajtje dhe nen hetime.

ESHTE FAJTOR

SEPSE: Me Zyrtari publik Sabri Ferati nga fshati Sfaraqak i Ulte komuna e Vushtrrise nuk e ka permbush obligimin ligjor qe parasheh ligji nr. 04/L-050 per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise se zyrtareve publik ne afatin ligjor prej dt.01.03 /12 e gjer me 31.03/12 per viti kalendarik 2011.

Me kete ka bere kundervajtje nga neni 17.par 1.3 te Ligjit per deklarimin , preardhjen de deklarmin e pasurise te zyrtareve te larte publike e ne pajtim me nenin 9 te LMK- es, dhe per kete:

DENOHET

ME DENIM NE TE HOLLA NE SHUME PREJ 1000 EURO te cilin gjobe ka per ta paguar ne afatin prej 15 ditesh nga dita e plotefuqishmeris se ketij aktvendimi e nese kete nuk e paguan e njejta do t` i zevendesohet me denim **BURGU** ne kohezgjatje prej 30 ditesh duke llogaritur per cdo dite vuajtje nga 15 euro.

Obligohet i pandehuri qe ne emer te paushallit gjqesor te paguaje ne shume prej 5 /pese euro /ne te njejten afat ligjor konform nenit 109 al 2 te LMK-es.

Nga nje kopje te aktvendimit te dergohet paleve.

Arsyetim

AGJENCIONI KUNDER KORRUPCIONIT NE PRISHTINE me kerkesen e vet nr, 01-254112 te dt. 24.07.2012 viti ka kerkuar zhvillimin e procedures kundervajtese



kunder te pandehurit Sabri Qazim Ferati nga Sfaraqaku i Ulte komuna e Vushtrrise, per kundervajtje nga neni 17 par. 1.3 te ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise te zyrtareve te lart publik.

I pandehuri Sabri Ferati eshte mare ne pyetje prane kesaj gjykate dhe i eshte bere me dije se munde te angzhoje mbrojtjen profesionale ne rastin konkret por deklaroi se nje mbrojtje e tille nuk eshte e nevojshme dhe deklaroi sa vijon;


E vertet eshte se per vitin kalendarik 2011 folmularin e kame mar pak me vones dhe plotesuar te njejtin mirepo per shkak te disa obligimeve familjare qe i kame pas ne Tirane Republika e Shqiperise nuk kame mujt ta deklaroj pasurise keshtu qe ne te ardhme do te keme kujdese dhe obligimin do ta kryej me kohe .

Ne cilesi te deshmitarit eshte mare ne pyetje ushtruesi i kerkeses kundervajtese Enis Sadiku i cili deklaroi; i pandehuri Sabri Ferati ka qene i obliguar ta deklaroje pasurin sipas nenin 9 te kerkeses se agjensise me qe keta kane qene per here te pare deklarues e me qe neni 9 prashehe se agjensija me gjdo kohe munde te kerkoje deklarimin e pasurise nga zyrtaret e larte publik e me qe i pandehuri nuk e ka kryer nje obligim te tille ne kemi ushruar fletparqitje ne menyre qe te miren masa adekuate ligjore, mirepo vlene te ceku se i pandehuri ne nje forme e ka pranuar faktin qe ka qene i njoftuar per deklarimin te pasurise por per shkak te eneglizhences se tije dhe mos kujdesit te duhur nuk e ka kryer obligimin ligjor me qe eshte deklaruar se aplikacionin e ka plotesuar edhe pse e ka mare pak me vones, mirepo per shkak te obligimeve familjare nuk ka mujte ta plotesoj folmularin dhe te ia dergoj agjencionit.

Gjithashtu ne cilesin deshmitarit u muar ne pyetje Ilmi Zeqiri zyrtar kontaktues i cili deklaroi une si person zyrtar kontaktues me kohe e kame informue sekretarin e kuvendit, qe ti informoj te gjitha personat zyrtar per obligimin ligjor per deklarimin e prardhjen e pasurise per vitim 2011 , kete e kame bere me shkeresen nr. 1021 te dt. 13.02/2012 viti, keshtu qe sekretaria ka qene e obliguar ta informoje secilin person dhe jam i bindur qe kjo sekretri me kohe e ka kryer obligimin e vet me qe shumica dermuese e zyrtareve e kane deklaruar prejardhjen e pasurise.

Deshmiari Haki Maloku pergjegjes i sekretarise te Kuvendit te Komunes ne Vushtrri deklaroi: eshte fakt i pamuheshem se Sabri Feratin dhe te gjitha delegatet e kuvendit komunale te Vushtrrise i kame informuar me kohe per obligimin ligjor te deklarimit te pasurise, ne afatin prej 01 marsi deri me 31 mars 2012 kete e kemi bere permes postes elektronikeme 15.03/2012 mirepo perveq kesaj edhe kryesuesi i mbledhjes se kuvendit ne muajin mars e ka informuar Sabri Feratin dhe te gjitha delegatet per obligimin ligjor duke kerkuar qe menjhere pa vones ta bejne me kohe njoftimin e AKKS-es permes plotesimit te folmularit.

Gjykata vleresoje kerkesen e paraqitur per inicimin e procedures kundervajtese, deklarimin e te pandehurit, deklarimin e deshmitarve si dhe te gjitha shkresat e lendes ne baze te cilave vertetoje ne menyre te plote dhe te drejte gjendjen faktike se i pandehuri Sabri Ferati ka qene i informuar me kohe per obligimin ligjor per deklarimin e pasurise per vitin 2011 ne afatin prej 01 mars deri m 31 mars 2012 mirepo kete obligim nuk e ka kryer, e me kete ka kryer kundervajtje nga neni nga neni 17. Par 1.3 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurise te zyrtareve te lart publik e ne pajtim me nenin 9 te LMK-es per cka te njejtin e shpallur rajtore dhe e denoje me denim ne te



03-2937/13/03
slu


holla si ne dispozitiv te ketij aktvendimi ndersa mbrojtjen e te pandehurit gjyqtari e HUDHI si te pa baze.

Me rastin e shqiptimit te denimit gjyqtari vleresoje te gjitha rrethanat nga neni 7 te LMK-es si rrethane letsuese u muar fakti se i pandehuri eshte hera e pare qe e ka kryer nje kundervajtje te till si dhe gjendjen ekonomike materiale te tij dhe i shqiptoi denimin si ne dispozitiv te ketij aktvendimi duke llogaritur se edhe me kete denim do te arrihet efekti i sanksionit, qe i pandehuri ne te ardhmen mos ta kryeje nje kundervajtje te ketille apo te ngjajshme.

Konform neni 109 al. 2 te LMK-es, caktohen shpenzimet e procedures kundervajtese ne shume prej 5 /pese/ euro.

Nga se u cek me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE –DEGA NE VUSHTRRI-
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM – DIVIZIONI I KUNDERVAJTJES**, me dt.
17.09/13 viti.



KESHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi i pandehuri dhe fleteushtruesi mund te ushtrojne ankes ne Gjykatën Themelore ne Mitrovicë –Dega ne Vushtri – Departamenti i Pergjithshem – Divizioni i Kundervajtjes ne Prishtine ne afatin prej 8 dite pas marrjes se te njejtit. Ankesa dergohet permes kesaj gjykate.